



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-46752 dt. 05.09 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 24.08.2022, ora 10:00.
Mbledhjen ë kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati, Azemine Bujupi Gjoka, Hamit Haxhiu, Arbër Halilaj, Florentina Elezi-Veliu si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale. Mungoi Malsore Cakiqi.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt.20.07.2022
2. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.
3. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Propozim Vendim për fillimin e Hartimit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e Qytetit Glllogoc.
5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klub Fitness Koca.
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit Volejbollit për Femra të OJQ-së KV Gryka .
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së „KF FORTUNA”
8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Boksit Drenas
9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi Publik i Futbollit Drenas
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së FC LIQENI Drenas
11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli **Meshkujt** Drenas.
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli **Femrat** Drenas
13. Propozim Vendim për financimin e Projektit botim i Librit monografi RFBSH Nezir Prokshi Drenas.
14. Propozim Vendim për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Tarifa Ngastra dhe Gjoha.
15. Njoftim rreth shikëputjes së Kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
16. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve Financiare nga Kategoria Rezervë.
17. Raporti i punës Janar-Qershor 2022 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
18. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës theksoi se kemi edhe dy pika shtesë për rendin e ditës: 1.Propozim Vendim për bartjen e mjeteve Financiare nga Kategoria Rezervë. 2.Raporti i punës Janar-Qershor 2022 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.

Arbër Halilaj, propozoj meqë nga pika e pestë deri tek pika e trembëdhjete janë të natyrës se njëjtë t'i votojmë si pako për me rekomandua për kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- është e rregulluar me rregullore gjë që duhet t'i votojmë secilën veç e veç, mirëpo këtu mundemi me i rekomandua gjitha për kuvend ndërsa ne mbledhjen e Kuvendit i votojmë veç e veç.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me dy pikat shtesë të cekura me lartë, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 20.07.2022**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.**

Arbër Halilaj, kërkoj disa sqarime çka ka risi të buxheti për vitin 2023-2025 nëse e krahasojmë me vitet paraprake.

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, me dt. 16.08.2022 si Kuvend Komunal e kemi marrë qarkoren e dyte buxhetore të Ministrisë së Financave e Punës dhe Transferove në këtë buxhet ndryshe nga buxheti i vitit të kaluar me kornizën afatmesme buxhetore kemi rritjen e kategorisë së pagave për periudhën 2023 nga 8,745,000 € në 9,038,054 € kjo ka ardh si rezultat i ndryshimit të numrit të stafit të punësuarve të Komunës së Drenasit ku kemi rritje të stafit në dy sektorët kryesor në sektorin e arsimit dhe në sektorin e shëndetësisë, në sektorin e shëndetësisë kemi ndryshim të stafit për 24 punëtor ndërsa në sektorin e arsimit për 17 ky është ndryshimi kryesor që është bërë në bazë të qarkores 2023/2 sa i përket kategorive tjera kanë mbet të njëjta sa i përket kategorive tjera buxheti ka mbet i njëjti siç e kemi aprovu muajin Qershor, shuma e përgjithshme e buxhetit mbetet e njëjta vetëm kategoria e pagave është rrit prej 8,745,000 € në 9,038,054 €.

Hamit Haxhiu, sa i përket sektorit të arsimit duke e ditur se numri i nxënësve është në rënie në bazë të qarkores buxhetore për vitin 2023-2024 në arsimin fillor kemi një ndryshim prej prej 22,925.000 € ndërsa në arsimin e mesëm afër 8989 € ndërsa nëse e marrum tabelën 24-25 e bëjmë krahasimin e shohim se arsimi fillor është 23.39.00 € ndërsa arsimi i mesëm 5242 €, a do të rritet numri i mësimdhënësve a do të rriten pagat nuk e kam të qartë.

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, kërkesat tona kanë qenë vazhdimisht për çerdhe është kërkuar që të rritet stafi, janë dy çerdhe që do të fillojnë njëra në vitin 2023 dhe aty duhet një staf i ri, rritet kategoria e pagave dmth si rritet numri i stafit është obligative që të rritet edhe shuma e pagave.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, vendet e punës janë të përcaktuara në arsim nuk është që do të hapet çerdhe të reja por rritet kapaciteti i objekteve të çerdheve, jemi duke i ndërtuar dy çerdhe të reja nuk është se do të bëhen 4 çerdhe por mbeten dy por stafi rritet rritja është 0.4 % e buxhetit për stazhin e punonjësve. Për çdo vit rritet përvoja e punës për këtë arsye edhe kemi rritje me të madhe.

Hamit Haxhiu, në shkollat e mesme çdo here është duke rënë numri i nxënësve dhe nuk e kuptoj se si në arsimin e mesëm ka rritje të mësimdhënësve kur çdo vit po bie numri i nxënësve?

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka- rritja e stafit ka të bëjë me politikat e reja të Ministrisë së Arsimit të cilët kanë paraparë specialist të IT-së, kanë paraparë mësimdhënës mbështetës për fëmijë me nevoja të veçanta dhe kjo rritje ka të bëjë me këtë kategori.

Florentina Elezi-Veliu, çka po ndodh që janë ndërpre punimet për ndërtimin e çerdes që një kohë të gjatë, sa kam info çerdhja ka pas me përfunduar këtë vit çka po ndodh?

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka- për shkak të ndryshimit të çmimeve të tregut edhe pse ka qenë projekt i financuar nga Bashkimi Evropian aktualisht vetëm 30 % janë të realizimit të punimeve kanë përfunduar edhe në deri nëntor ka qenë afati me përfunduar projekti por nuk ka përfunduar ju kemi drejtë ministrisë me shkresë dhe jemi larg me punime dhe po shihet që nuk do të përfundojnë punimet ata kanë kërkuar në qeveri që me e rrit buxhetin 20% janë duke negociuar për shkak të ndryshimit të tregut dmth. operatorët nuk po kanë llogari kjo ishte përgjigjja.

Azemine Bujupi-Gjoka, po dihet që shumë projekte nuk janë duke u realizuar për shkak të pagesës që kanë ndërruar çmimin mirëpo a nuk e kanë ata për obligim pasi që ata kanë aplikuar dhe ju ka dhënë tenderi a duhet ata me marrë ndonjë përgjegjësi patjetër me e përfunduar atë projekt sepse e kanë pranuar në fillim me e përfunduar punën pa marrë parasysh a ngritën çmimet apo jo.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, me ligj është një nen ku thotë forca madhore kur lëvizin këto kushte kanë të drejtë me u tërheq, qeveria po bënë përpjekje ngritjen e çdo projekti i cili ka qenë në proces për 20%. Pasi diskutime dhe vërejtjeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 05 vota (Për), 1 abstenim, kundër nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Arbër Halilaj, tek anëtar i sektorit jo qeveritar, me pas parasysh me qenë një ekonomist ose ndonjë biznesmen që din me e bërë vlerësimin të arsyeshmerisë ekonomike të dhënies të një prone.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, është e paraparë me ligj që komisioni me u formu nga kuvendi disa, prej qeverisjes dhe nga OJQ-ve.

Pasi diskutime dhe vërejtjeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për fillimin e Hartimit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e Qytetit Glllogoc.**

Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit-Flutura Avdiu, me Hartën Zonale të komunës parashihet që përmes kësaj të hartohen edhe planet rregulluese të hollësishme dhe të fillohet me hartimin e planit rregullues për qendrën e qytetit, ne kemi lidhur një kontratë kornizë me kompaninë INSI-Shpk për tri vjet që të fillohet me zona të caktuara sepse Harta Zonale i përcakton kushtet e zhvillimit mirëpo më detajisht i kërkon edhe planet rregulluese të hollësishme pasi që qendra e qytetit ka më shumë nevojë ku kemi filluar me qendrën e qytetit për këtë vit ku na nevojitet një plan i hollësishëm rregullues ku kemi filluar me hapësirat e zonave urbane pasi që me miratimin e Hartës Zonale do të fillojnë ndërtimet e mesme dhe te larta kështu që nevojitet një detajizim dhe një profil i gjendjes ekzistuese të qytetit.

Hamit Haxhiu, a e ke fjalën për zgjerimin e sheshit apo për çka është fjala?

Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit-Flutura Avdiu, nuk nënkupton zgjerimin e sheshit por nënkupton por nënkupton komplet qendrën e qytetit, zona e cila hartohet plani rregullues është në sipërfaqe prej 110 Ha, dmth kushtet e hartimit janë me në detaj se Harta Zonale.

Azemine Bujupi-Gjoka, a ka me u mbajt ndonjë debat lidhur me këtë që qytetaret me propozu qfar plani do të behet qka do të ndërtohet?

Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit-Flutura Avdiu, ky është një propozim vendim për me fillu me u hartu plani rregullues, pasi ta pranojmë draftin e planit rregullues, kur ta përfundon kompania atëherë del me ligj 30 siç parashihet në shqyrtim publik pranohen vërejtët komentet sugjerimet, mbahet një debat me qytetar komentet prej 30 dit kur të inkorporohet shkon në miratim për Kuvend pastaj në MAPL. Pas diskutime dhe vërejtjeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin nga pika e pestë deri tek pika e trembëdhjetë të rendit të ditës:

5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klub Fitness Koca.
 6. Propozim Vendim për financimin e Projektit Volejboli për Femra të OJQ-së KV Gryka
 7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së „KF FORTUNA”
 8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Boksit Drenas
 9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi Publik i Futbollit Drenas
 10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së FC LIQENI Drenas
 11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli
- Meshkujt Drenas**

12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli
Femrat Drenas

13. Propozim Vendim për financimin e Projektit botim i Librit monografi RFBSH Nezir
Prokshi Drenas.

Florentina Elezi-Veliu, sa i përket subvencionimeve pyeti Klubi Feronikeli a nuk ka berë kerkese për me marr subvencione sepse e dina që është njëra nder klubet që është financuar më së shumti viteve tjera 60-70% e subvencioneve e tani nuk kane apliku qka po ndodh? Kërkoj me ia bashkangjit secilit propozim vendim një arsyetim me pas informacion për secilin klub sea po ia japim vlersimin e drejt, sot abstenoj që për seance me ia bashkangjit një arsyetim.

Arbër Halilaj, unë jam për gjitha këtyre subvencionimeve por pse nuk është klubi i qytetit Hendbollit Drenica, e di që janë në gjendje të keqe sikurse shumë klube tjera si qëndron puna tek subvencionimi i tyre, ndërsa në përgjithësi për të gjitha tek neni 4 e kisha caktu një afat se deri kur duhet me e dorezu raportin e implementimit të projektit.

Shpend Bogiqi- zyrtar në Drejtorinë e Kultures, Klubi i Futbollit Feronikeli nuk ka berë kerkese për mbështetje financiare, po ashtgu edhe klubi i volejbollit nuk ka berë kerkese.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, klubi futbollistik Feronikeli është shuajt, ligjërisht është berë klubi Futboll klub Feronikeli 1974 për shkak të borgjeve të medhaja mbi 800 mij euro dhe është formu klub i ri i cili është fuzionua me klubin Fortuna dhe ligjërisht është pranua nga Federata e Futbollit të Kosovës, ndërsa sa i përket klubit hendbollistik Drenica nuk kane apliku fare, arsyetimi i kryetarit te klubit ka qenë se ka qenë në pushim që nuk ka pas mundësi me apliku mirëpo sipas informacioneve nuk e kane pas raportin financiar që duhet me e bërë.

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport- Laureta Thaqi, të qeshtja e vendimit tek neni 4 na për secilin përfitues e nënshkruajmë edhe nje kontrate ne menyre që t'i përmbahen asaj kontrate, në kontrate eshte e cekur edhe periudha apo afati se kur duhet me e sjelle raportin narrativ apo financiar, përfituesit deri ne fund të vitit duhet me e sjellë nje raport financiar prej ku i kane dergu mjetet që i kane përfitua nga komuna, ndërsa përfituesit qe përfitojnë jashtë thirrjes publike është deri me 31 mars vitit fiskal tjetër.

Azemine Bujupi-Gjoka, edhe unë pajtohem që me iu subvencionua këtyre kategorive mirëpo mire është me pas secila nga këto me pas nga një arsyetim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, raportin financiar kur ta sjellë me e berë kërkesën tjetër për vitin tjetër ka me e sjellë raportin financiar a i ka shpenzu mjetet për qka i ka kerku.

Hamit Haxhiu, gjitha këto organizata kanë bërë kërkesa për mbështetje a ka edhe ndonjë organizatë që ka bërë ndonjë kerkese e që është refuzua kërkesa e tyre?

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport- Laureta Thaqi, ka edhe individ që kanë apliku dhe nuk janë përfitues sepse nuk i kanë plotësua kriteret e thirrjes publike, kriteret e thirrjes publike bazohen në rregulloren e Ministrisë së Financave 04/2017 si dhe me rregulloren e komunës për kushtet dhe ndarjen e subvencioneve janë edhe arsyet pse janë refuzua.

Pas diskutime dhe vërejtjeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim nga pika e 5 deri tek pika e 13 e rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 05 vota (**Për**), kundër nuk pati, 1 **abstenim**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin nga pika e katërmëdhjetë të rendit të ditës: **14. Propozim Vendim për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Tarifa Ngastra dhe Gjoba.**

Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik - Egzona Jetullahu, duke u lidhur me këte pike duke pasqyruar ndryshimet e shpeshta të ligjeve në Republikën e Kosovës si dhe rëndësinë e harmonizimit të kësaj rregullore me ligjet e aplikueshme keqkrojmë që të formohet komisioni për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Tarifa Ngastra dhe Gjoba.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin nga pika e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës: **15. Njoftim rreth shkëputjes së Kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit..**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin nga pika e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve Financiare nga Kategoria Rezervë.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin nga pika e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës: **17. Raporti i punës Janar-Qershor 2022 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin nga pika e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës: **18. Të ndryshme.**


Florentina Elezi- çka duhet bërë pasi që tani erdhi shtatori dhe po fillojnë shkollat për me e zgjat orarin e autobusëve sidomos Prishtinë-Drenas.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, linjat nder urbane i përcakton dikush tjetër nuk i përcakton komuna, ndërsa linjat brenda komunës i përcaktojmë ne.

Pasi që nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen e KPF-së.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11:05 min.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi




Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Milaim Hajdari